

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6630
E mërkurë, 15 qershor 2022
çmimi 0.40 €

Schallenbergu në Kosovë: Liberalizimi i vizave të ndodhë sa më parë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS TË ENJTEN KA MBAJTUR SEANCË

LV-ja ME NDIHMËN E LISTËS SERBE E KALON PROJEKTLIGJIN PËR PAGËN MINIMALE, OVLUÇK-ja PROTESTON TË ENJTEN

FAQE 4-5



Me 68 vota për, asnjë kundër dhe gjashtë abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të martën në parim Projektligjin për pagën minimale. Projektligji parashih ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfutimit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës

minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Ky projektligj është kundërshtuar nga veteranët e UÇK-së për shkak të mospërfshirjes së tyre në rritjen e pagës minimale. OVLUÇK-ja ka paralajmëruar këtë të enjte protestë, duke e quajtur Kuvendin institucion të turpër

90 për qind e kontributdhënësve në Trust kanë kursime më pak se 10 000 euro

FAQE 6



PARLAMENTI EVROPIAN: MARRËVESHJA FINALE KOSOVË - SERBI TË BAZOHET NË NJOHJEN RECIPROKE

FAQE 3

AKTUALE



BE-ja NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR SHPËRNDARJEN E 110 MIJË DOZAVE TË VAKSINËS PËR LINË E MAJMUENËVE

F. 2

EDHE NË KOSOVË SHËNOHET DITA BOTËRORE E DHURIMIT TË GJAKUT

F. 6

DEPUTETËT KROATË RITHEKSOJNË MBËSHTETJEN E KROACISË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

F. 7

EKONOMI



RRETH GJYSMË MILIONI EURO PENSIONE PËR PERSONA TË VDEKUR

F. 8

SPORT



KLUBET SHOIPTARE MËSOJNË KUNDËRSHTARËT NË GARAT EVROPIANE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia fitoi 93 miliardë euro nga eksporti i naftës që nga nisja e luftës

MOSKË, 14 QERSHOR - Rusia fitoi 93 miliardë euro nga eksportet e karburanteve fosile gjatë 100 ditëve të para të luftës së saj në Ukrainë, tregon një raport i ri. Bashkimi Evropian importoi 61 për qind të eksporteve të karburanteve fosile të Rusisë gjatë kësaj periudhe, sipas raportit të Qendrës për Kërkime për Energjinë dhe Ajrin e Pastër (CREA).

Të ardhurat e Rusisë nga karburantet fosile vijnë së pari nga shitja e naftës së papërpunuar, e

ndjekur nga tubacionet e gazit, prodhimet e naftës, gazi natyror i lëngshëm (LNG) dhe qymyri. Raporti i kësaj organizate me bazë në Finlandë u publikua më 13 qershor, ndërsa Kievi vazhdon t'i kërkojë Perëndimit ta ndërpresë të gjithë tregtinë me Rusinë me shpresën për ta ndërprerë financimin e saj për luftën. Bashkimi Evropian muajin e kaluar ra dakord për një marrëveshjeje kompromisi që shkurton importet e naftës ruse në më shumë se dy të tretat, duke

synuar naftën ruse të dërguar nga deti, ndërsa përjashtoi përkohësisht naftën e dorëzuar nga tubacionet. Raporti i CREA-s thotë se rritja globale e çmimeve të naftës do të thotë që arkat e Kremlinit vazhduan të mbusheshin edhe pse eksportet e Rusisë ranë gjatë muajit maj. Çmimet mesatare të eksportit të Rusisë ishin rreth 60 për qind më të larta se vitin e kaluar, duke ndihmuar të ardhurat e Rusisë nga eksporti të arrijnë nivelet më të larta, sipas



CREA. Kina, India, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Franca janë ndër

vendet që kanë rritur blerjet e këtyre lëndëve djegëse fosile nga Rusia.

BE-ja nënshkruan marrëveshje për shpërndarjen e 110 mijë dozave të vaksinës për linë e majmunëve

BRUKSEL, 14 QERSHOR - Komisioni Evropian nënshkroi të martën një marrëveshje me kompaninë farmaceutike daneze "Bavarian Nordic" për mbi 110 000 doza vaksinash për ta luftuar shpërthimin e vazhdueshëm të lisë së majmunëve. Ndryshe nga vaksinat e COVID-19, të cilat u kontraktuan nga Komisioni Evropian, por paguheshin individualisht nga vendet e BE-së, kontrata mbi vaksinat për linë e majmunëve do të financohet fillimisht nga buxheti i përbashkët i BE-së.



Kjo është hera e parë që buxheti i BE-së po përdoret për të blerë vaksina në mënyrë që të mund të shpërndahen sa më shpejt në

vendet anëtare. Që nga 18 maji i këtij viti rreth 900 raste të lisë së majmunëve janë raportuar në 19 vende të BE-së, në

Norvegji dhe Islandë. Dërgesat e para të dozave do të fillojnë në fund të qershorit, në ato vende që kanë më shumë nevojë. Lija e majmunit është një virus që e ka origjinën te kafshët e egra, si brejtësit dhe primatët, dhe që ndonjëherë kalon edhe te njerëzit. I përket të njëjtës familje virusesh të lisë. Infektimi i parë të njeriu ndodhi në vitin 1970 te një djalë në një zonë të largët të Kongos. Në vitin 2003, 47 persona në gjashtë shtete amerikane u infektuan nga qentë

e egër që jetonin pranë disa gjitarëve të vegjël të importuar nga Gana. OBSH-ja vlerëson se tashmë ka mijëra raste të tilla në vit kryesisht në vende afrikane dhe se kjo sëmundje mund të rezultojë fatale për 1 në 10 persona. Shumica e pacientëve të infektuar me linë e majmunit kanë vetëm temperaturë, dhimbje në trup, ethe dhe lodhje. Njerëzit e sëmurë më rëndë mund të kenë irritim të lëkurës në fytyrë dhe duar që mund të përhapet në pjesë të tjera të trupit.

Zelensky i bën thirrje Gjermanisë të ketë qëndrim më të qartë për luftën në Ukrainë

KIEV, 14 QERSHOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka bërë thirrje kancelarit gjerman Olaf Scholz të ketë pozicion më të qartë për luftën e Rusisë në Ukrainë. "Neve na duhet që kancelari Scholz të sigurojë që Gjermania e mbështet Ukrainën. Ai dhe qeveria e tij duhet të vendosin", ka thënë Zelensky në një intervistë për transmetuesin gjerman ZDF. Gjermania nuk duhet të tentojë

të gjejë një balancë në marrëdhënien me Ukrainën dhe lidhjet me Rusinë, ka thënë presidenti ukrainas. "Gjermania ka nisur të dërgojë armë më vonë sesa shtetet fqinje. Ky është fakt", ka thënë Zelensky. Në fillim Gjermania dhe Franca e kanë mbështetur Ukrainën vetëm në aspektin politik dhe retorik, ka shtuar ai. Scholz ka hedhur poshtë kritikant se Gjermania është duke vepruar


shumë ngadalë për dërgim të armëve të rënda në Ukrainë. "Ne do t'i dërgojmë të gjitha armët për të cilat jemi pajtuar", ka thënë Scholz të hënën, duke shtuar se forcat ukrainase duhet të trajtohen për përdorim të armëve. "Janë armë tejet të rënda. Duhet të mësoheni t'i përdorni, duhet të trajtoheni", ka thënë Scholz, duke shtuar se ushtarët ukrainas janë duke kryer trajnime në Gjermani për këtë gjë.



Konflikti në Ukrainë mund t'i rrisë problemet me drogën

KIEV, 14 QERSHOR - Pushtimi rus në Ukrainë mund të përballë më shumë njerëz me lëndë narkotike, ka paralajmëruar Agjencia e BE-së për Droga. Kjo Agjenci ka thënë në raportin e saj vjetor se shumë njerëz që kanë përjetuar "stres të nivelit të lartë", si pasojë e konfliktit, mund të jenë më të rrezikuar ndaj keqpërdorimit me substanca në të ardhmen. Trafikuesit e drogës mund të

gjejnë rrugë alternative për t'i shmangur zonat me prani të lartë të forcave të sigurisë, është thënë në raport. Aty është përmendur edhe se shërbimet shëndetësore në shtetet evropiane, sidomos ato në kufi me Ukrainën, ka mundësi të mbingarkohen pasi mund të rritet numri i përdoruesve të drogës që kërkojnë ndihmë teksa i ikin konfliktit. "Vazhdimi i trajtimit, kërkesat për akomodim dhe



mbështetje shtesë, do të mund të jenë probleme kyçe", është thënë në raport, duke shtuar se edhe ata që nuk janë përdorues droge do të mund të jenë në rrezik.

Agjencia ka thënë se situata e rëndë financiare në Afganistan, pas marrjes së kontrollit nga talibanët në gusht të vitit të kaluar, mund t'i bëjë të hyrat nga droga si burim i rëndësishëm për jetesë dhe kjo mund të çojë në rritje të trafikimit të heroinës në Evropë. Sipas përpiluesve të raportit, pavarësisht ndalesës në prodhim, shitje dhe trafikim të llojeve të drogave ilegale, kultivimi i tyre vazhdon në Afganistan. "Disa lloje

drogash nuk kanë qenë kurrë më të qasshme dhe substancat e reja vazhdojnë të qarkullojnë, secili mund të preket, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo", ka thënë drejtori i Agjencisë së BE-së për Drogat, Alexis Goosdeel. Sipas të dhënave të fundit, një rekord prej 213 tonëve të kokainës janë konfiskuar në BE, dhe mbi 350 laboratorë ilegalë për prodhim të drogave janë shkatërruar më 2020.

Kuvendi i Kosovës të enjten ka mbajtur seancë

LV-ja me ndihmën e Listës Serbe e kalon Projektligjin për pagën minimale, OVLUÇK-ja proteston të enjten

Me 68 vota për, asnjë kundër dhe gjashtë abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të martën në parim Projektligjin për pagën minimale. Projektligji parasheh ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfitimit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Ky projektligj është kundërshtuar nga veteranët e UÇK-së për shkak të mospërfshirjes së tyre në rritjen e pagës minimale. OVLUÇK-ja ka paralajmëruar këtë të enjte protestë, duke e quajtur Kuvendin institucion të turpit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka votuar të martën në parim projektligjin i cili hap rrugë për rritjen e pagës minimale. Me 68 vota për, përfshirë edhe ata të Listës serbe, është miratuar ky projektligj.

Deputetët nga 6+ kanë abstenuar. Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës nuk kanë marrë fare pjesë në seancë me arsyetimin se veteranëve po u bëhet e padrejtë. Ky projektligj i miratuar në parim në Kuvendin e Kosovës është

pagës”, ka shkruar Murati në llogarinë e vet në “Facebook”. Projektligji, i cili synon rritjen e pagës minimale, ka për qëllim t’i ndryshojë dhe plotësojë ligjet e përcaktuara në të cilat ndërlidhin shumën e përfitimeve apo kompensimeve me pagën minimale. Po ky projektligj ndryshon shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore si dhe procedurën e vendosjes së pagës minimale. Sipas projektligjit të miratuar në parim, Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale, sipas propozimit të



kundërshtuar nga veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për shkak të mospërfshirjes së tyre në rritjen e pagës minimale.

Veteranët e UÇK-së kanë protestuar më 6 qershor para Kuvendit të Kosovës për shkak të mospërfshirjes së pensioneve të tyre në rritjen e pagës minimale. Ata sërish kanë paralajmëruar protestë për këtë të enjte. Projektligji i miratuar parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht.

Pas miratimit në parim të projektligjit, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se projektligji do t’u ndihmojë më shumë se 100 mijë punëtorëve të cilët paguhen më pak se 264 euro. “Pas 11 vjetëve stagnim, më në fund do ta kemi rritjen e pagës minimale që ndihmon mbi 100 mijë punëtorë të sektorit privat që aktualisht punojnë për pagë nën 264 euro. Mbi 380 mijë të punësuar të cilët marrin më shumë pagë neto sepse hiqet tatimi për 250 eurot e para të

Këshillit Ekonomiko-Social. Por, në mungesë të një propozimi nga ky Këshill, ministri për Financa mund të parashtrijë një propozim për pagën minimale për qeverinë. Projektligji ndryshon dhe plotëson Ligjin për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ligjin për personat e verbër dhe Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Te veteranët ky projektligj thekson se ‘deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për Financa, vendos për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual’.

Veteranët e UÇK-së protestojnë të enjten

Pas miratimit të Projektligjit për pagën minimale, ku nuk përfshihen veteranët e UÇK-së, ka

reaguar Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së. Kjo organizatë ka bërë me dije se të enjten në orën 9:30 do të protestojë para Kuvendit të Kosovës. “Kuvendi i turpit të Kosovës, deputetët e pushtetit (me ndonjë përjashtim) së bashku me pakicat, të rrethuar me forca policore, miratuan në lexim të parë projektligjin për ndryshimin e ligjeve, me anë të të cilit u përjashtuan veteranët e luftës së UÇK-së edhe nga paga minimale. Ata vepruan sot edhe kundërligjshëm e kundër aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, pra kundër Ligjit 05/L-141, i cili thotë në nenin 16 A pika 3.1. ‘Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik’, pra ligji bazik është ai që i lidh veteranët me pagën minimale. Për shkak të këtij turpi të deputetëve të Kuvendit, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së ftojnë protestë gjithëpopullore para institucioneve (Kuvend dhe Qeveri) me datën 16 qershor 2022 prej orës 09:30. Dalja sa më masive në protestë nënkupton mbrojtje të institucionit më të lartë, luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kategorive të saj”, ka njoftuar OVLUÇK-ja.

Krasniqi: Mospërfshirja e veteranëve të UÇK-së në pagën minimale, turp

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në një konferencë për medie mbajtur në Kuvendin e Kosovës, ka thënë se injorimi i veteranëve nga qeveria

Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje është turp i madh, pjesë e të cilit Partia Demokratike e Kosovës nuk do të bëhet kurrë dhe do ta kundërshtojë fuqishëm. “Propozimet tona kanë qenë që paga minimale të jetë në nivelin e tillë, që ta mundësojë mbulimin e nevojave elementare për punëtorët dhe familjet e tyre, gjë që nuk është as për së afërmi e kënaqshme me propozimin e qeverisë që e ka sjellë me projektligjin aktual e që është sot në rend të ditës. Por në vend se të fokusoheshim për t’i shqyrtuar mundësitë dhe për të ndërtuar një politikë të mirëfilltë që përmes përcaktimit të pagës minimale të arriheshin disa objektiva sociale, qeveria e ka devijuar komplet debatin duke vendosur njëanshëm dhe në mënyrë të turpshme, që t’i përjashtojë kategoritë e veteranëve të UÇK-së nga ky ripërcaktim i pagës minimale”, ka thënë Krasniqi.

Lideri i PDK-së ia kujtoi qeverisë Kurti se veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë më meritoret për lirinë tonë dhe se shteti ynë dhe pavarësia jonë e kanë në themel luftën për liri të këtyre burrave e grave që kanë rrezikuar jetën dhe kanë lënë pjesët e trupit nëpër vija të frontit. “Fatkeqësisht, kryeministri Kurti dhe qeveria e udhëhequr prej tij me vetëdije të plotë është duke u përpjekur ta shkëpusë kujtimin dhe nderimin e kësaj sakrifice. Qasja e kësaj qeverie në mënyrë të vazhdueshme e ka shpërfillur lavdinë dhe sakrificën e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe këtë shpërfillje është duke e manifestuar edhe zyrtarisht përmes këtij projektligji. Me

vendimin për të mos e përfshirë kontributin e veteranëve të UÇK-së në ligjin që e ripërcakton pagën minimale, kryeministri është duke u përpjekur t’i lëkundë themelet e dinjitetit të këtyre burrave e grave, që janë më meritoret për lirinë që e gëzojmë sot. Kjo nuk është vetëm padrejtësi ndaj veteranëve, por edhe përpjekje për ta tjetërsuar të vërtetën historike mbi të cilën qëndron themeli i lirisë dhe pavarësisë sonë”, ka thënë ai. Krasniqi, duke e konsideruar këtë sjellje të papërgjegjshme karshi veteranëve si absurde dhe të pafalshme, i bëri thirrje qeverisë që ta kthejë prapa këtë projektligj dhe mos ta procedojë tutje për miratim.

Haradinaj: Sot në Kuvend janë kthyer Rrahman Morina dhe UDB-a

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, në një konferencë për medie, pas votimit në parim të Projektligjit për pagën minimale, ka thënë se sot është një ditë e çuditshme për Kuvendin e Kosovës, duke kundërshtuar mospërfshirjen veteranëve të UÇK-së në këtë projektligj. Ai ka thënë se sot është parë një fitore e fëmijëve të UDB-së, të përkratur nga Lista Serbe. “Sot jemi të sigurt që në Kuvend është kthyer Rrahman Morina, UDB-a dhe serbët”, ka thënë ai. Haradinaj ka thënë se do të vazhdojnë të mos pajtohen me këtë projektligj, ndonëse nuk i ka bërë me dije format e kundërshtimit.



Parlamenti Evropian: Marrëveshja finale Kosovë - Serbi të bazohet në njohjen reciproke

Komisioni për Punë të Jashtme i Parlamentit Evropian (AFET) për herë të parë ka thënë se marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të bazohet në njohjen reciproke. Ky komision të martën ka miratuar raportin për Kosovën, në të cilin i është bërë thirrje Këshillit të BE-së që urgjentisht ta marrë vendimin për liberalizimin e vizave. Eurodeputetja Viola von Cramon ka theksuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave që në vitin 2018. Në raport e AFET-it është përfshirë edhe mbështetja ndaj kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, sikur edhe thirrja për pesë vendet anëtare të bllokut evropian, të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, që ta bëjnë një gjë të tillë

vetimit se dëshira e tij është që pas zgjedhjeve të prillit dhe luftës së agresionit rus, partnerët në Serbi ta kuptojnë se sa urgjente është të shkohet para në rrugën e tyre evropiane. “Mund të bëhet më shumë për të ecur me vendosmëri drejt BE-së dhe si raportues i PE-së jam i gatshëm të punoj së bashku me lidhshpirtin e ri në Beograd për të ndihmuar në arritjen e ndryshimeve pozitive për Serbinë evropiane”, ka thënë Bilçiku.

Po ashtu, autoriteteve serbe u është kërkuar të veprojnë kundër glorifikimit të kriminelëve të dënuar të luftës dhe të ndalojnë çdo retorikë dhe veprim që cenon integritetin e vendeve fqinje dhe rrezikon stabilitetin dhe pajtimin rajonal.

Raportuesi Vladimir Bilçik ka thënë se është ankuar edhe për presionin e vazhdueshëm ndaj gjyqësorit dhe mohimin publik të gjyqësorit ndërkombëtar të krimeve të

luftës. Më tutje, ai i ka bërë thirrje shumicës së sapozgjedhur që t'i forcojë garancitë për pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit si çështje me prioritet.

Komisioni i Parlamentit Evropian për Politikë të Jashtme (AFET) ka miratuar të martën edhe raportet për Kosovën dhe Bosnjën e Hercegovinën.

Në raportin për Kosovën, ky komision i ka bërë thirrje Këshillit të BE-së që urgjentisht ta marrë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, kurse në raportin për Bosnjën është dënur ashpër çdo përpjekje, e cila minon shtetësinë e këtij vendi.

Raportet e votuara do të shfaqen në seancën plenare të PE-së në korrik, kur këto versione të tekstit do t'i marrin format e rezolutave të Parlamentit Evropian (PE).

Këto rezoluta kanë peshë politike, por nuk janë obliguese për vendet anëtare të BE-së.

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

STRASBURG, 14 QERSHOR - Parlamenti Evropian (PE) për herë të parë ka thënë se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të bazohet në njohjen reciproke. Ky vlerësim është paraqitur të martën gjatë votimit të amendamentit në raportin përfundimtar për Serbinë në Komisionin për Punë të

Jashtme të Parlamentit Evropian (AFET).

Për këtë raport kanë votuar 50 anëtarë të AFET-it, pesë ishin kundër dhe tre kanë abstenuar.

Krahas marrëdhënieve me Kosovën dhe sundimit të ligjit në vend, raporti i votuar përfshin edhe harmonizimin me politikën e sanksioneve kundër Rusisë si përcaktues i përparimit të përgjithshëm të Serbisë në procesin e anëtarësimit në BE.

Autoriteteve në Beograd u është kërkuar të tregojnë përkushtim të vërtetë ndaj vlerave të Bashkimit Evropian (BE) dhe t'i harmonizojnë vendimet dhe pozicionet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë sanksionet kundër Rusisë.

Raportuesi i përhershëm për Serbinë në Parlamentin Evropian (PE) dhe autori i raportit në fjalë, Vladimir Bilçik, ka thënë pas

90 për qind e kontributdhënësve në Trust kanë kursime më pak se 10 000 euro

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Instituti GAP ka organizuar të martën tryezë diskutimi dhe ka publikuar raportin "Ndikimi i tërheqjes së kursimeve pensionale deri në 30 për qind në ekonominë e Kosovës". Agron Demi, drejtor i hulumtimeve në Institutin GAP, ka treguar se qëllimi i këtij raporti është ta analizojë ndikimin që mund të ketë aprovimi i këtij projektligji në kursimet e qytetarëve në Trust, ekonomi dhe funksionimin e Trustit. Rrona Zhuri, hulumtuese në Institutin GAP, ka paraqitur të gjeturat kryesore të raportit dhe ka

theksuar se ky projektligji do të prekë mbi 695 000 mijë kontributdhënës të Trustit dhe në rast të tërheqjes nga të gjithë këta kontributdhënës, gjithsej shuma e tërhequr do të jetë 594 milionë euro.

Rreth 90 për qind e kontributdhënësve në Trust kanë kursime në vlerë më të ulët se 10 mijë euro dhe prej tyre, rreth 337 mijë qytetarë do të mund të tërheqin mesatarisht nga 96.5 euro, meqenëse kursimet e tyre nuk i arrijnë as 1 000 euro. Për më shumë, ajo theksoi se futja e një shume të këtij lloji në ekonomi do

të ndikonte në rritjen e kërkesës, duke rënduar kështu edhe më shumë situatën me rritjen e çmimeve.

Si përfundim, Instituti GAP ka rekomanduar që të vazhdohet me politika për zbutjen e krizës, si dhe të bëhet reformimi i Skemës së Ndhmës Sociale, ngaqë kriteret aktuale ligjore, se kush mund të përfitojë nga kjo skemë, lënë shumë familje të varfra jashtë skemës.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës, ka theksuar se Qeveria e Kosovës është kundër

tërheqjes së kursimeve pensionale dhe se nuk e përkrah një nismë të tillë. Sipas Bislimit, nisma të tilla që synojnë ta prekin fondin pensional do të dërgojnë në shkatërrimin e kësaj shtylle të rëndësishme të shtetit. Për më shumë, ai theksoi se numri më i madh i kontributdhënësve do të mund të tërhiqnin një pjesë të vogël të mjeteve në kuadër të këtij ligji dhe se rritja e parasë në treg në një periudhë kur po përballemi me inflacion të importuar nuk është politikë adekuate.

Bekim Haxhiu, deputet i Kuvendit të Kosovës, gjithashtu edhe

iniciues i plotësim-ndryshimit të këtij projektligji, ka theksuar se tërheqja e kursimeve pensionale nuk do të ndikojë në investimet e Trustit pensional. Ai tregoi se tërheqja e kursimeve bëhet në mënyrë vullnetare dhe se mjetet e tërhequra do t'u ndihmonin qytetarëve që ta kalonin më lehtë këtë periudhë të ngritjes së çmimeve.

Në tryezë morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, sikurse nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe mediet.



Çfarë thuhet në raportin për Kosovën?

Në raportin për Kosovën, të cilin e ka paraqitur raportuesja për Kosovën në këtë trup, Viola von Cramon, ka theksuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave që në vitin 2018, por ende nuk është miratuar vendimi për liri të lëvizjes. Në raport përfshihet edhe mbështetja ndaj kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, sikur edhe thirrja për pesë vendet anëtare të bllokut evropian të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, që ta bëjnë një

gjë të tillë.

Në raportin e miratuar deputetët e Parlamentit Evropian (PE) kanë deklaruar synimin e Kosovës për të aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në fund të këtij viti, por ka theksuar se nuk ka procedurë të shpejtë dhe se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është i nevojshëm për Kosovën që të përparojë në rrugën e saj evropiane.

Anëtarët e AFET-it kanë përsëritur mbështetjen e tyre për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe kanë përsëritur rëndësinë e angazhimit konstruktiv ndërmjet autoriteteve të

Serbisë dhe të Kosovës në mënyrë që të arrihet normalizimi gjithëpërfshirës ligjor dhe i detyrueshëm.

Në këtë raport është thënë se marrëveshja është vendimtare për të dyja vendet që të përparojnë në rrugët e tyre evropiane. Si Kosova ashtu edhe Serbia janë paralajmëruar se është i domosdoshëm zbatimi i plotë i të gjitha marrëveshjeve të mëparshme, përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Anëtarët e AFET-it në raport kanë thënë se shprehin keqardhje për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta refuzuar propozimin që do ta

lejonte mbledhjen e fletëve të votimit për qytetarët me të drejtë vote në Kosovë për zgjedhjet serbe të 3 prillit 2022 siç ishte rasti më parë.

Gjithashtu, ata kanë përsëritur miratimin e një rezolute të Kuvendit të Kosovës që dënon fuqishëm agresionin ushtarak të Federatës Ruse dhe pushtimin e Ukrainës, dhe kanë vlerësuar Kosovën për përafrimin e saj me BE-në duke miratuar sanksione kundër Rusisë.

Kosovës i është bërë ftesë ta vazhdojë procesin e reformave, luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit, ndonëse është konstatuar se Kosova ka shënuar një përparim në këtë drejtim.

Në këtë drejtim është përsëritur propozimi për reformën në prokurori dhe është kërkuar që të merret parasysh mendimi i Komisionit të Venecias. Për raportin për Kosovën janë paraqitur edhe amendamentet. Një numër i madh i tyre janë paraqitur nga disa deputetë nga Spanja, të cilët kanë propozuar që nga raporti të largohen të gjitha referencat që e trajtojnë Kosovën si shtet. Ndërsa disa deputetë nga e djathta ekstreme, më së shumti nga Franca dhe Gjermania, kishin propozuar që në vend të thirrjes për liberalizim vizash, të thuhet se "vizat nuk duhet të liberalizohen në një të ardhme të afërt".

Nënkryetari i komunës së Mitrovicës viziton fermerët në fshatin Bajgorë

MITROVICË, 14 QERSHOR (ER) - Nënkyetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu, kanë vizituar disa fermerë në fshatin Bajgorë.

Gjatë kësaj vizite fermerët Behxhet dhe Naim Beqiri

njoftuan nënkryetarin Tahiri dhe drejtorin Kadriu lidhur me sfidat dhe vështirësitë të cilat po i hasin ata dhe fermerët e tjerë në përgjithësi, por njëkohësisht shpalosën edhe të arriturat e tyre, ku aktualisht në fermën e tyre kanë 30 krerë lopë dhe kultivojnë mbi 2 hektarë tokë

me patate. Me këtë rast, drejtori i DBZHR-së, Ferdi Kadriu, ka thënë se fermerët e tillë janë shembujt më të mirë se si duhet shfrytëzuar të mirat që ofron natyra dhe toka e vendit tonë, njëherë në këtë mënyrë kontribuohet edhe në zhvillimin e sektorëve të ndryshme të bujqësisë.



Komuna e Gjilanit nxjerr në diskutim publik planin e veprimit për transparencë 2022-2026

GJILAN, 14 QERSHOR (ER) - Komuna e Gjilanit ka nxjerrë në diskutim publik planin e veprimit për transparencë 2022-2026, të cilin e ka paraqitur drejtoresha e Administratës së Përgjithshme, njëherësh kryesuese e grupit punues, Doruntina Hasani.

Gjatë paraqitjes, Hasani ka thënë se ky propozim-plan është hartuar dhe përgatitur si model nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe është në përputhje me legjislacionin e fundit dhe i cili u është përshtatur nevojave të funksionimit të të gjitha sektorëve të komunës së Gjilanit, përfshirë zyrën e kryetarit, drejtoritë dhe Kuvendin Komunal. "Plani ka për qëllim që t'i krijojë disa korniza me qëllim që të veprojmë brenda përbrenda atyre kornizave, t'i respektojmë

dispozitat ligjore dhe nënligjore të aplikueshme, në mënyrë që të rritet llogaridhënia e organeve të komunës dhe të jemi sa më transparentë në veprimet e vendimet që ndërmarrin organet e komunës", ka thënë drejtoresha Hasani.

Në kuadër të këtij plani është paraparë publikimi i njoftimeve për takimet e kuvendit të komunës, transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit, publikimi i akteve të Kuvendit, publikimi i planit të punës, ofrimi i qasjes së drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike, publikimi i raporteve të punës së Kuvendit, publikimi i profileve të anëtarëve të Kuvendit, e publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve.

Po ashtu, plani katërvjeçar parasheh publikimin e akteve të kryetarit, përfshirjen e hershme



të publikut në procesin e planifikimit, publikimi i listës së pronave të planifikuara për dhënie për shfrytëzim, mbajtja e takimeve publike e

konsultimeve të tjera me publikun, shqyrtimi i kërkesave e peticioneve të qytetarëve, mbajtja e takimeve me qytetarë për KAB-in, mbajtja e

konsultimeve me qytetarë për projekt-buxhetin e komunës, diskutimi i raportit të kryetarit të komunës në Kuvendin Komunal etj.

Edhe në Kosovë shënohet Dita Botërore e dhurimit të gjakut



PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Të martën është shënuar edhe në Kosovë Dita Botërore e dhurimit vullnetar të gjakut, ditë e cila i kushtohet ndërgjegjësimit të popullatës për të dhuruar vullnetarisht gjak.

Për këtë vit slogani i Ditës Botërore të dhurimit të gjakut është "Dhurimi i gjakut është një akt solidariteti".

Në mesazhin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë thuhet se gjaku dhe produktet e sigurta të gjakut janë thelbësore për t'i ndihmuar njerëzit që vuajnë nga sëmundje, fatkeqësi dhe aksidente. "Dhënia e gjakut është një akt solidariteti shpëtimtar. Shërbimet që ofrojnë gjak të sigurt dhe produkte të gjakut janë

thelbësore për çdo sistem të kujdesit shëndetësor", thuhet në mesazhin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në përgjigje të thirrjes për dhurimin vullnetar të gjakut, sekretari i përgjithshëm, dr. Naim Bardiqi dhe zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Shëndetësisë, u janë përgjigjur pozitivisht përpjekjeve për të shpëtuar jetë përmes dhurimit vullnetar të gjakut.

Ky aktivitet është organizuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut e Kosovës, mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të aktiviteteve të tjera, të cilat, gjithashtu, do të zhvillohen gjatë gjithë Javës së Dhurimit Vullnetar të Gjakut 2022.

Për katër ditë në Klinikën Emergjente kërkuar ndihmë mjekësore 1 200 persona

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për katër ditë kanë kërkuar ndihmë mjekësore 1 200 persona. Prej këtyre, 241

janë trajtuar në Dhomën e Reanimimit (Dhoma e Kujdesit të Avancuar Emergjent) dhe 212 pacientë janë regjistruar si raste kirurgjike. Ndërsa në

Dhomën e Shërbimit Internistik kanë marrë trajtim mjekësor 391 pacientë dhe në Dhomën e Shërbimit Ortopedik janë trajtuar 283 raste.



Schallenberg në Kosovë: Liberalizimi i vizave të ndodhë sa më parë



Ministri federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Alexander Schallenberg, pas takimit me ministren e Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se Kosova dhe Austria kanë marrëdhënie të shkëlqyera në të gjitha fushat. Ai ka thënë se liberalizimi i vizave për Kosovën duhet të ndodhë sa më parë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Ministri federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Alexander Schallenberg, ka thënë se liberalizimi i vizave për Kosovën duhet të ndodhë sa më parë. Gjatë qëndrimit në Prishtinë, Schallenberg ka paralajmëruar se në samitin e radhës në mes të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të zhvillohet më 23 qershor, ai do ta shtrojë temën e liberalizimit të vizave për Kosovën. "Të hapen

negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe të bëhet liberalizimi i vizave për Kosovën. Austria do ta kërkojë këtë gjë në mënyrë aktive. E kemi bërë në të kaluarën dhe do të vazhdojmë ta bëjmë edhe më tutje", u shpreh ministri i jashtëm austriak. Po ashtu, Schallenberg ka theksuar se BE-ja duhet t'i hapë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai i bëri komentet gjatë një konference të përbashkët për medie me ministren e Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla. Kosova është vendi i vetëm në

Ballkanin Perëndimor që nuk gëzon liberalizim të vizave me BE-në.

Kryediplomati austriak tutje u shpreh se situata në Ukrainë duhet të shërbejë si thirrje që BE-ja të zgjohet dhe ta trajtojë anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në familjen e saj.

Schallenberg ka përmendur edhe çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se në fund të këtij procesi duhet të ketë normalizim të plotë dhe njohje, e cila, sipas tij, nuk vihet në dyshim fare.

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka njoftuar se në takim me ministrin Federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Alexander Schallenberg, kanë biseduar edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gërvalla ka theksuar se në takim me ministrin austriak ka përmendur gatishmërinë dhe seriozitetin e

Kosovës për procesin e dialogut, i cili, sipas saj, do të përfundonte shumë shpejt nëse Serbia nuk do të vazhdonte me përpjekjet për bllokim. Ajo ka thënë se në takim kanë biseduar edhe për thellimin e bashkëpunimit Kosovë - Austri, duke potencuar se në mesin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Austria meriton të veçohet si aktor i rëndësishëm i integritimit evropian të Kosovës.

Edhe presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takim ministrin e Jashtëm të Republikës së Austrisë, Alexander Schallenberg. Në takim presidentja Osmani ka diskutuar me ministrin Schallenberg për angazhimin e Kosovës në rrugën evropiane të saj.

Presidentja ka theksuar se Kosova ka plotësuar kriteret për liberalizim të vizave andaj, sipas saj, i takon BE-së që ta mbajë premtimin në raport me popullin e Kosovës. Në këtë kontekst, Osmani ka kërkuar mbështetjen austriake jo vetëm

për këtë çështje, por edhe për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Gjatë diskutimit për zhvillimet në raport me agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës, presidentja Osmani ka deklaruar se qëndrimi i Kosovës është plotësisht në përputhje me BE-në, ShBA-në dhe të gjitha vendet demokratike.

Kurse për dialogun Kosovë - Serbi, Osmani ka theksuar se ai duhet të përqendrohet në njohjen reciproke. "Kosova është palë konstruktive në këtë proces dhe rendi kushtetues, sovraniteti dhe kufijtë aktualë janë të panegociueshëm", ka thënë presidentja Osmani.

Në takim u diskutua edhe për marrëdhëniet ndërshtetërore, në të cilin të dyja palët shprehën gatishmëri për thellimin e tyre, në fushën e politikës së jashtme, arsimit, shkëmbimit tregtar, si dhe fusha të tjera të interesit reciprok.

Deputetët kroatë ritheksojnë mbështetjen e Kroacisë për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar edhe nga nënkryetarja Saranda Bogujevci, ka pritur të martën në takim një delegacion të Komisionit Parlamentar për Integritim Evropian nga Kroacia, në përbërje nga deputeti Domagoj Hajduković, kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, deputetja Ermina Lekaj-Prljaskaj, kryetare e Grupit Parlamentar të Miqësisë Kroaci-Shqipëri dhe Gabriela Kuhariq-Kojiq, këshilltare në Komisionin për Çështje Evropiane. Me këtë

rast, kryetari Konjufca ka falënderuar deputetët kroatë për mbështetjen e vazhdueshme që Kroacia i ka dhënë Kosovës në të gjitha etapat shtetndërtuese dhe proceset e saj integruese. Për më tepër, kryetari i Kuvendit e ka vlerësuar të shkëlqyer bashkëpunimin dypalësh në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë si në nivel politik dhe parlamentar, po ashtu edhe në atë social ndërkohë që, siç është shprehur, ekziston një interesim i dyanshëm që fushat e bashkëpunimit të

avancohen edhe në sferën e ekonomisë.

Ndërsa deputetët kroatë ritheksojnë mbështetjen e rezervuar të Kroacisë për liberalizimin e vizave, si dhe procesin e integritimit të Republikës së Kosovës në BE dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Në takim u theksua vullneti për thellimin e bashkëpunimit ndërparlamentar, duke vlerësuar rolin e grupeve parlamentare të miqësisë si një faktor i rëndësishëm të marrëdhënieve mes dy shteteve tona.



Rreth gjysmë milioni euro pensione për persona të vdekur

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Jo të gjitha vdekjet që ndodhin në Kosovë regjistrohen brenda afatit kohor në zyrat e regjistrimit të gjendjes civile nëpër komunat përkatëse, thonë përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Me ligj deklarimi i vdekjes duhet të bëhet nga një pjesëtar madhor i familjes, me një raport mjekësor, brenda 30 ditësh nga vdekja. Por, vonesat në deklarim kanë bërë që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës vetëm vitin e kaluar të paguajë afro gjysmë milioni euro për pensione të personave të vdekur.

Sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të publikuar këtë muaj, kjo ministri ka paguar 3 314 pensione pas vdekjes së përfitueseve, në vlerë mbi 465 mijë euro.

Juristë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare thonë se për t'i evituar vonesat në lajmërimin e vdekjeve duhet digjitalizuar sistemin e regjistrimit midis institucioneve shëndetësore dhe zyrave komunale të regjistrimit civil.

Zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë nuk i janë përgjigjur pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" nëse kanë ndonjë sistem elektronik, ku regjistrojnë personat e vdekur në spital.

Nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës thonë se nëse personi vdes në ndonjërin prej reparteve të këtij institucioni, QKUK-ja i plotëson disa formularë, që dorëzohen edhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. "Faqja e parë e formularit i bashkëngjitet historisë së pacientit, e cila mbetet në klinikën përkatëse. Faqja e dytë është për ASK-në dhe faqja e tretë për komunën përkatëse. Këto dy faqe të formularit, pas një periudhe kohore, ASK-ja i merr nga QKUK-ja dhe njërin prej tyre e dërgon në komunë, tjetërën e mban për vetë. Ndërkohë, faqja e katërt, pasi të vdesë pacienti, bashkë me fletëvdekjen dhe fletëleshimin [nga spitali] i takon familjarit", sqarojnë nga QKUK-ja për REL-in, por pa dhënë detaje nëse kanë ndonjë sistem elektronik ku regjistrohen të vdekurit.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar zyrtarë të komunës së Drenasit, në pjesën qendrore të Kosovës, të cilët konfirmojnë se nuk ka ndonjë bazë të përbashkët të të dhënash midis institucioneve shëndetësore dhe zyrave komunale.

Lumnije Prenaj, udhëheqëse e Shërbimit të Gjendjes Civile në këtë komunë, thotë se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Drenas nuk i përcjell në mënyrë elektronike rastet e vdekjes në Zyrën Komunale për



Regjistrimin Civil. Sipas saj, rastet e vdekjeve regjistrohen me kërkesën e familjarëve - fizikisht në komunë - dhe "në shumicën e rasteve me vonesë".

Procesi i regjistrimit të vdekjeve në Kosovë

Me Ligjin për Gjendjen Civile, çdo vdekje që ndodh në territorin e Kosovës duhet të regjistrohet nga anëtarët e familjes nëpër komunat përkatëse brenda 30 ditësh, ndërsa për ato që ndodhin jashtë territorit, afati për regjistrim është 60 ditë.

Të gjitha vdekjet që ndodhin në institucionet shëndetësore, por edhe në shtëpi, duhet të konfirmohen nga mjeku kompetent i cili lëshon certifikatën e vdekjes. Më pas, kërkesën për regjistrimin e të vdekurit familjarët duhet ta paraqesin fizikisht në zyrat komunale, bashkë me certifikatën e lëshuar nga institucioni shëndetësor, e cila konfirmon vdekjen e personit.

Nëse nuk ka ndonjë certifikatë të tillë, atëherë regjistrimi i vdekjes bëhet me dy dëshmitarë para gjykatës, të cilët kanë qenë të pranishëm në momentin e vdekjes së personit apo gjatë varrimit të tij. Nëse vdekja nuk lajmërohet brenda afatit të caktuar, familjarët mund të gjobiten nga 50 deri në 100 euro.

Digjitalizimi përmirëson procesin

Mentor Seferi, nga organizata joqeveritare Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, thotë se procesi i regjistrimit të vdekjes nuk mund të mbetet në vullnetin e familjarëve, por se nevojitet digjitalizimi i sistemit të regjistrimit.

"Komunikimi elektronik mes institucioneve shëndetësore është i domosdoshëm për këtë proces", thekson ai.

Juristi Hasim Krasniqi, i cili më herët ka punuar në Agjencinë për Regjistrimin Civil, thotë se problem në këtë aspekt paraqesin vdekjet natyrale që ndodhin në shtëpi. "Në shumicën e rasteve vdekjet natyrale që ndodhin në shtëpi nuk konfirmohen as nga mjeku. Këtu ka ngecje. Dhe është një praktikë e qytetarëve që, pa iu nevojitur ndonjë dokument, nuk shkojnë ta regjistrojnë personin e vdekur", thotë Krasniqi. Sipas tij, Agjencia për Regjistrimin Civil dhe komunat duhet të gjejnë "forma obliguese" që t'i regjistrojnë vdekjet me kohë, por nuk specifikon se cilat do të mund të ishin ato.

Me ligj, kur vdekja ndodh në shtëpi, personat që janë të pranishëm duhet ta thërrasin mjekun për ta konfirmuar atë.

Të gjitha rastet e vdekjes duhet ta kenë konkluzionin se cili ka qenë shkaku i vdekjes së personit të cilin e lëshon institucioni shëndetësor.

Pas regjistrimit në komunat përkatëse, me ato të dhëna shërbehet Agjencia për Regjistrimin Civil, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Erdon Arifaj, zëvendës i drejtorit të Departamentit të Gjendjes Civile në këtë agjenci, shpjegon për REL-in se si funksionon ajo: "Regjistrimi i vdekjeve bëhet nga zyrtari i gjendjes civile brenda në sistem. Është një sistem unik. Ato [të dhënat] grumbullohen në regjistrin qendror të shtetaseve - regjistër ky që administrohet nga ne. Pra, për të gjitha rastet, kur qytetari e deklaron vdekjen [e familjarit], ne i kemi informatat dhe ato i shpërndajmë tek institucionet përkatëse".

Me këto të dhëna çdo muaj shërbehet edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës, e cila ekzekuton mjetet e pensioneve. Vlera e pensionit në Kosovë sillet nga 100 euro - pensionet e pleqërisë - deri në 264 euro, varësisht kualifikimit arsimor.

Në bazë të ligjit pensionistët duhet të paraqiten në Zyrën e Pensionistëve çdo gjashtë muaj për të dëshmuar se janë gjallë.

Ministria e Financave: Mbi 151 mijë euro janë kthyer në buxhet

Skënder Asllani, zëvendës drejtor në Departamentin e Pensioneve në Ministrinë e Financave, thotë se ky institucion funksionon në bazë të të dhënave nga Agjencia për Regjistrimin Civil. "Ne kemi raste që pala të vdesë pas datës 15 [të muajit], por ne jemi të obliguar që t'ia bartim mjetet sa është në jetë [në fillim të muajit] dhe kjo tingëllon se ministria po gabon. Ne çdo muaj i marrim të dhënat nga Agjencia për Regjistrimin Civil", thotë Asllani.

Në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit thuhet se "mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave shkakton pagesa të parregullta dhe dëmton buxhetin e ministrisë".

Kjo zyrë i ka rekomanduar Ministrisë së Financave që ta analizojë në hollësi çështjen e pagesave dhe t'i shqyrtojë mundësitë për kthimin e tyre në rast se u dërgohen përfituesve të vdekur.

"Kthimi i mjeteve bëhet në mënyrë vullnetare nga familjarët e pensionistit të vdekur, e që kanë marrë pension pas vdekjes së pensionistit. Por, në rastet kur këto mjete nuk kthehen në mënyrë vullnetare, iniciohen procedura gjyqësore", thonë për REL-in nga zyra për informim e Ministrisë së Financave. Sipas saj, nga pagesat "e gabuara" për njerëz të vdekur vitin e kaluar, deri më tash janë kthyer mbi 151 mijë euro në buxhet.

Ministria e Financave thotë se gabimet kanë ndodhur për shkak se, që nga shpërthimi i pandemisë Covid-19 në mars të vitit 2020, Qeveria e Kosovës, me një vendim të saj, i ka liruar të gjitha kategoritë e pensionistëve që të paraqiten çdo gjashtë muaj në zyrat e pensionistëve.

Përveç pagesave për persona të vdekur, Ministria e Financave ka paguar gabimisht edhe mbi 405 mijë euro të tjera për ndihma sociale, pensione të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pensione të punëtorëve të kombinatit metalurgjik "Trepça", ka gjetur Zyra Kombëtare e Auditimit.

NIALL FERGUSON INTERVISTON GJIGANDIN E POLITIKËS SË JASHTME AMERIKANE

99-vjeçari Henry Kissinger: Po hyjmë në një periudhë shumë të vështirë

Henry Kissinger mbushi 99 vjeç më 27 maj. I lindur në Gjermani në kulmin e hiperinflacionit të Vajmarit, ai nuk kishte mbushur ende dhjetë vjeç kur Hitleri erdhi në pushtet dhe ishte vetëm 15 vjeç kur ai dhe familja e tij zbankuan si refugjatë në qytetin e Nju Jorkut. Është pothuajse po aq e habitshme që ky ish-sekretar i shtetit i SHBA-së dhe gjigant i gjeopolitikës, u largua nga posti 45 vjet më parë.

Ndërsa shkoi drejt mbushjes së shekullit të tij, Kissinger nuk ka humbur aspak nga fuqia intelektuale që e dallonte nga profesorët dhe praktikuesit e tjerë të politikës së jashtme, të brezit të tij dhe të brezave të mëpashtëm. Gjatë kohës që kam kaluar duke shkruar vëllimin e dytë të biografisë së tij, Kissinger ka botuar jo një, por dy libra – i pari, si bashkëautor me ish-CEO e Google Eric Schmidt dhe ekspertin e shkencave kompjuterike Daniel Huttenlocher, mbi inteligjencën artificiale, i dyti një përmbledhje e gjashhtë rasteve studimore biografike në udhëheqje.

U takuam në shtëpinë e tij në fshat, thellë në pyllin e Connecticut, ku ai dhe gruaje e tij, Nancy, kanë kaluar shumicën e kohës që nga fillimi i Covid. Pandemia solli edhe të mirat e veta për ta. Ishte hera e parë në 48 vjet martesë që Dr Kissinger-i u ndal me forcë. I shkëputur nga tundimet e restoranteve të Manhattanit dhe banketeve të Pekinit, ai ka humbur disa kilogramë. Megjithatë ecën me shkop, është i varur nga një aparat dëgjimi dhe flet më ngadalë se në atë baritonin e pagabueshëm të një herë e një kohe, mendja e tij është më e mprehtë se kurrë më parë.

Kissingeri nuk e ka humbur as aftësinë e tij për të zemëruar profesorët liberalë dhe studentët progresivë të "zgjuar" që dominojnë Harvardin, universitetin ku ai ndërtoi reputacionin e tij si studiues dhe intelektual publik në vitet 1950 dhe 1960.

Çdo sekretari shteti dhe këshilltari për sigurinë kombëtare (post i parë që mbajti në qeveri) i është dashur të bëjë zgjedhje midis opsioneve të këqija dhe atyre më të këqija. Antony Blinken dhe Jake Sullivan, të cilët aktualisht mbajnë ato poste, vitin e kaluar e braktisën popullin e Afganistanit në duar të Talibanëve dhe këtë vit po dërgojnë armë me vlerë dhjetëra miliarda dollarë në zonën e luftës që është Ukraina. Në një farë mënyre, këto veprime nuk risjellin sulmet që i janë drejtuar Kissinger-it ndër vite për rolin e tij në ngjarje të tilla si Lufta e Vietnamit (një sasi e konsiderueshme kritikash kanë ardhur edhe nga e djathta, megjithatë për arsye shumë të ndryshme).

Asgjë nuk mund të ilustrojë më mirë aftësinë e tij për të tërbuar majtas dhe djathtas, sesa polemika e ndezur nga fjalimi i tij i shkurtër në Forumin Ekonomik Botëror në Davos më 23 maj. "Henry Kissinger: Ukraina duhet t'i japë Rusisë territor", ishte titulli i The Telegraph, duke ngjallur shifra pothuajse të barabarta

postimesh të tërbuara në Twitter, si nga progresistët që kanë shtuar ngjyrat blu dhe të verdha të Ukrainës në versionin më të fundit të flamurit të krenarisë, ashtu edhe nga neokonservatorët që po përpiqen për një fitore të Ukrainës dhe ndryshimin e regjimit në Moskë. Në një përgjigje të ashpër, presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, akuzoi Kissingerin se po favorizonte zbutjen me Rusinë fashiste në stilin e vitit 1938.

Gjëja më e çuditshme rreth zhurmës që u shkaktua, ishte se Kissinger nuk tha asgjë të tillë. Duke argumentuar se duhet të negociohet një lloj paqeje, ai thjesht deklaroi se "vija ndarëse [midis Ukrainës dhe Rusisë] duhet të jetë një kthim në status quo ante" – që do të thotë në situatën para 24 shkurtit, kur pjesë të Donetskut dhe Luhanskut ishin nën kontrollin e separatistëve pro-Moskës dhe Krimea ishte pjesë e Rusisë, siç ka ndodhur që nga viti 2014. Këtë e ka thënë vetë Zelensky në më shumë se një rast, megjithatë disa zëdhënës ukrainas kanë argumentuar kohët e fundit për një kthim në kufijtë e para 2014-ës.

Keqinterpretimet të tilla nuk janë asgjë e re për Kissingerin. Kur ai po përpiquej të bindte Barack Obamën të tërhiqej nga Afganistani, zëvendës-presidenti, Joe Biden, tërhoqi një analogji fatkeqe me ish-presidentin e SHBA Richard Nixon. "Ne duhet të largohemi," i tha ai diplomatit veteran Richard Holbrooke, "për të bërë atë që bëmë në Vietnam". Holbrooke, përfaqësuesi special i Obamës për Afganistanin dhe Pakistanin, u përgjigj se ai "mendonte se kishim një detyrim ndaj njerëzve që na kishin besuar". Përgjigja e Biden ishte domethënëse: "Po çfarë thua!", thuhet se i tha ai Holbrooke. "Ne nuk duhet të shqetësohemi për këtë. Ne e bëmë në Vietnam. Nixon dhe Kissinger ia dolën mbanë."

Megjithatë, realiteti ishte, përsëri, krejt ndryshe. Nixon dhe Kissinger hodhën plotësisht poshtë idenë e braktisjes së Vietnamit të Jugut në fatin e tij, pasi protestuesit kundër luftës ia kërkuan në 1969-ën. Në vend që të minimizonin dëmin dhe të iknin, ata kërkuan të arrinin "paqe me nder". Strategjia e tyre e "Vietnamizimit" ishte një fakt një version i asaj që SHBA po bën sot në Ukrainë: sigurimin e armëve në mënyrë që vendi të mund të luftojë për të mbështetur pavarësinë e vet, në vend që të mbështetet në ushtarët amerikanë në terren.

Tipat e Harvardit dhe Yale do të përçahen edhe më shumë kur ata të shohin Nixonin si një nga gjashtë ekzemplarët në "Leadershipin" e Kissingerit, krah Konrad Adenauer, Charles de Gaulle, ish-presidentit egjiptian Anëar Sadat, kryeministrit të parë të Singaporit, Lee Kuan Yee dhe Margaret Thatcherit.

E pyes Kissingerin se si Nixon – i vetmi president i detyruar të japë dorëheqjen – meriton një kapitull në një libër mbi udhëheqjen. A nuk është ai një rast studimor se si të mos drejtosh? Kissinger fillon me verdiktin e përmbledhur për Ëatergate, të dhënë nga Bryce



Harloë, operatori me përvojë në Uashington, i cili kishte qenë ndërlidhësi i Nixon me Kongresin: "Një drejt budallai hyri në Zyrën Ovale dhe bëri siç i thanë" – që do të thotë se dikush në Shtëpinë e Bardhë e kishte marrë Nixonin pak si shumë fjalë për fjalë. "Si një propozim i përgjithshëm," thotë Kissinger, "asistentët u detyrohen parimeve të tyre në politikë që të mos mbahen pas deklaratave emocionale [për] gjëra që e dinë se nuk do t'i bënin pas reflektimit të mëtejshëm." Kishte shumë raste kur, në vrullin e momentit, ose për t'i bërë përshtypje personit që kishte përballë, Nixon i jepte urdhra verbale të papërmbytura. Kissinger mësoi shpejt të mos vepronte sa herë që Nixon e urdhëronte t'i "fuste një bombardim dikujt" dikujt.

"Nëse shikoni Ëatergate," argumenton ai, "ishte me të vërtetë një varg shkeljesi" – duke filluar me hyrjet e paligjshme në selinë e Komitetit Kombëtar të Partisë Demokratike, të cilat u urdhëruan nga fushata për të rizgjedhur Nixon në vitin 1972. Ato shkelje më pas "u bashkuar në një hetim. Mendova atëherë dhe mendoj tani se ata e meritonin censurën; ata nuk kërkuan largimin nga detyra."

Nga këndvështrimi i Kissinger-it, Ëatergate ishte një katastrofë sepse shkatërroi strategjinë e zgjuar të politikës së jashtme që ai dhe Nixon kishin hartuar për të forcur pozicionin e Shteteve të Bashkuara, që në fakt e kishin humbur Luftën e Ftohtë kur ata erdhën në detyrë në janar 1969. "Ne kishim një projekt madhështor," kujton ai. "[Nixon] donte t'i jepte fund Luftës së Vietnamit me kushte të respektueshme... Ai donte t'i jepte aleancës Atlantike një drejtim të ri strategjik. Dhe mbi të gjitha ai donte të shmange një konflikt [bërthamor] [me Bashkimin Sovjetik] përmes politikës së kontrollit të armëve."

"Dhe pastaj ishte misteri i paeksploruar i Kinës. [Nixon] shpalli që në ditën e tij të parë se donte t'i hapej me Kinën. Ai e kuptoi se kjo ishte një mundësi strategjike, se dy kundërshtarë të Shteteve të Bashkuara ishin në konflikt me njëri-tjetrin" – një referencë për luftën kufitare që shpërtheu midis Bashkimit Sovjetik dhe Kinës në vitin 1969, pasi dy fuqitë më të mëdha komuniste ishin ndarë për çështje ideologjike tetë vjet më herët. "Në emër të tij dhashë një udhëzim që të përpiquej të vendosim veten më afër Kinës dhe Rusisë, se sa ato

ishin mes tyre." Këto tendenca, thotë ai, po bashkoheshin në vitin para se të shpërthente skandali Ëatergate. "Në fund të presidencës së Nixonit, kishte një paqe në Vietnam, e cila në kushtet e saj ishte e nderuar dhe e qëndrueshme nga një president që kishte mbështetur e brendshme. Ne kishim ribërë politikën e Lindjes së Mesme," duke dëbuar efektivisht sovjetikët nga rajoni dhe duke vendosur SHBA-në si ndërmjetës të paqes midis arabëve dhe izraelitëve. Fatkeqësisht, mbështetja e brendshme u shpërbë. Në vend që t'i shfrytëzonim ato mundësi, ne u detyruam nga situata e brendshme e Nixon-it që thjesht të mbaheshim.

Nixon që del nga "Leadershipin" i Kissinger-it është një figurë tragjike – një strateg mjeshter, mbulimi i paskrupullit i krimin të ekipit të fushatës së tij të rizgjedhjes, shkatërroi jo vetëm presidencën e tij, por dënoi edhe Vietnamin e Jugut me shkatërrim. As kjo nuk ishte e gjitha. Ishte disfata në Vietnam, sugjeron Kissinger, ajo që e vendosi SHBA në një spirale në rënie të polarizimit politik.

"Konflikti," shkruan ai, "futi një stil debati publik të zhvilluar gjithnjë e më pak mbi thelbin, sesa për motivet dhe identitetet politike. Zemërimi zëvendësoi dialogun si një mënyrë për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe mosmarrëveshja është bërë një përplasje kulturore."

E pyes nëse SHBA është më e ndarë sot se në kohën e Vietnamit. "Po, pafundësisht më shumë," përgjigjet menjëherë. "I befashuar, i kërkoi të ma shtjellojë. Në fillim të viteve 1970, thotë ai, ekzistonte ende një mundësi për dypartizim. "Interesi kombëtar ishte një term kuptimplotë, ai nuk ishte në vetvete një temë debati. Por kjo ka marrë fund. Çdo administratë tani përballet me armiqtë e pandërprerë të opozitës dhe në një mënyrë që është ndërtuar mbi premisa të ndryshme... Debatit i padeklaruar, por shumë real në Amerikë tani për tani është nëse vlerat bazë të Amerikës kanë qenë të vlefshme," me të cilën ai nëkupton statusin e shenjtë të Kushtetutës dhe përparësinë e lirisë individuale dhe barazisë para ligjit.

Një republikan që nga vitet 1950, Kissinger shmang deklarimin në mënyrë eksplicite se ka elementë në të djathtën amerikane që tani duket se i vënë në dyshim ato vlera. Por ai nuk është më i entuziazmuar nga tipa të tillë

populistë sesa ishte në kohën e Barry Goldëater, kandidati presidencial i viteve 1960, i cili ishte një mbrojtës i madh i individualizmit dhe një antikomunist i ashpër. Në të majtën progresive, thotë ai, njerëzit tani argumentojnë se "nëse këto vlera bazë nuk përmbysen dhe nuk ndryshohen parimet e ekzekutimit [të tyre], ne nuk kemi të drejtë morale as të zbatojmë politikën tonë të brendshme, aq më pak politikën tonë të jashtme". Kjo "nuk është ende një pikëpamje e përhapur, por është mjaftueshëm virulente për të shtyrë çdo gjë tjetër në drejtimin e saj dhe të pengojë politikën bashkuese.

E pyes: "A mund ta rregullojë ndonjë udhëheqës këtë?" "Ajo që ndodh nëse ka ndarje të pakapërcyeshme është një nga dy gjërat. Ose shoqëria shembet dhe nuk është më e aftë të kryejë misionet e saj nën udhëheqje, ose i kapërcen ato..."

"A ka nevojë për një goditje të jashtme apo një armik të jashtëm?" "Kjo është një mënyrë për ta bërë. Ose mund të keni një krizë të pakontrollueshme të brendshme."

E kthej pas te udhëheqësi më i vjetër i profilizuar në librin e tij, Konrad Adenauer, i cili në vitin 1949 u bë kancelari i parë i Gjermanisë Perëndimore. Në takimin e tyre të fundit – sigurisht që Kissinger i njohte të gjashtë personalisht – Adenaueri e pyeti: "A është ende në gjendje ndonjë lider të zhvillojë një politikë të vërtetë afatgjatë? A është ende i mundur leadershipi i vërtetë sot?" Kjo është me siguri pyetja që vetë Kissingeri ngrë, gati gjashtë dekada më vonë.

Leadershipi është bërë shumë më i vështirë, thotë ai, "për shkak të kombinimit të rrjetëve sociale, stileve të reja të gazetarisë, internetit dhe televizionit, të cilat të gjitha e përqendrojnë vëmendjen në afat të shkurtër."

Kjo na sjell tek pikëpamja e tij shumë e veçantë për leadershipin. Gjashtë udhëheqësit në librin e tij kishin pesë cilësi: ata flisnin për të vërtetë të vështirë, kishin vizion dhe ishin të guximshëm. Por ata ishin edhe të aftë të kalonin kohë me veten, në vetmi. Dhe nuk kishin frikë të ishin përçarës.

"Duhet të ketë një moment reflektimi në jetën e liderit", thotë ai, duke treguar për kohën e mërgimit të brendshëm të Adenauer-it në Gjermaninë naziste; kohën e de Golit si një i burgosur në Luftën e Parë Botërore; Vitet e vështira të Nixonit në mesin e viteve 1960 pasi ai kishte humbur garat si për presidencën ashtu edhe për guvernator të Kalifornisë; kohën e burgut të Sadatit kur Egjipti ishte ende nën kontrollin britanik. Disa nga pasazhet më mbresëlënëse të librit kanë të bëjnë me këto periudha izolimi. "Dominimi i vetes duhet të bëhet një lloj zakoni," shkruante de Gaulle si një i burgosur lufte, "një refleks moral i fituar nga një gjimnastikë e vazhdueshme e vullnetit, veçanërisht në gjërat më të vogla: veshja, të biseduarit, mënyra se si mendon."

Fundi i pjesës së parë / Sunday Times – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Klubet shqiptare mësojnë kundërshtarët në garat evropiane

Ballkani, që është kampion i Kosovës në rrethin e parë kualifikues, do të përballlet me kampionin e Lituanisë, Zhalgiris. Në Ligën e Konferencës, Drita kundërshtarë e ka skuadrën e Inter Turkut, ndërkaq Gjilani do të luajë kundër skuadrës letoneze Liepajan. Llapi ka punë me skuadrën malazeze Buduçnosti



Tetova, përballlet me FC Ararat nga Jerevani i Armenisë.

Nuhui: Në këto nivele çdo skuadër ka cilësitë e veta

Në kuadër të raundit të parë kualifikues të Ligës së Konferencës, FC Drita do të takohet me FC Inter Turku nga Finlanda. Trajneri Ardian Nuhui ka thënë se në këto nivele garash çdo skuadër ka cilësitë e veta dhe kundërshtari meriton respekt maksimal. "Në këto nivele çdo skuadër ka cilësitë dhe vlerat e veta, prandaj kundërshtari ynë meriton respekt maksimal dhe një analizë të detajuar. Kemi kohën e mjaftueshme për të analizuar ekipin e FC Inter Turku, pasi që kampionati në Finlandë është ende duke u zhvilluar. Kjo na mundëson që të marrim edhe më tepër informacione për kundërshtarin tonë dhe ne të vazhdojmë punën e përgatitjes", ka thënë Nuhui.

shqiptare që marrin pjesë në Ligën e Kampionëve, Tirana dhe Shkupi, pasi kanë evituar skuadrat më të vështira të mundshme që kishin përballë në vazot e tyre dhe kanë kundërshtarë në këtë tur ekipet më të përballueshme me shanse reale për kualifikimin. Tirana ka "peshkuar" Dudelanzhin e Luksemburgut, ndërsa Shkupi

do të përballlet me Linkolnin e Gjibraltarit. Në Ligën e Konferencës, Partizani do të ndeshet me Saburtalon e Gjeorgjisë. Të kuqtë ndeshjen e parë do ta luajnë në transfertë më 7 korrik, kurse atë të kthimit një javë më vonë në Shqipëri. Me fat ishte skuadra e Laçit që do të përballlet me malazezët e Iskras. Skuadra tjetër shqiptare, Shkëndija nga

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Futbollit i Kosovës do të përfaqësohet me katër skuadra në garat evropiane. Kampioni në fuqi, Ballkani, bën gara në Ligën e Kampionëve dhe kundërshtar për raundin e parë kualifikues do ta ketë kampionin e Lituanisë, Zhalgiris. Ndeshjen e parë skuadra nga Suhareka do ta luajë si vendase në stadiumin "Fadil Vokrri" më 5 ose 6 korrik, kurse ndeshjen e kthimit pas një jave. Skuadra nga Suhareka për herë të parë në historinë e vet merr pjesë në garat evropiane. Të martën është hedhur shorti edhe për

Ligën e Konferencës, aty ku do të marrin pjesë tri skuadrat e Kosovës, Drita si nënkampione, Gjilani si skuadra e tretë në renditjen tabelore dhe Llapi si fituese e Kupës. Shorti i hedhur në selinë e UEFA-s në Nyon e ka vendosur Dritën përballë skuadrës nga Finlanda, Inter Turku, ndërkaq Gjilani do të luajë me skuadrën letone Liepajan. Skuadra që drejtohet nga Tahir Batatina përballlet me skuadrën e njohur malazeze Buduçnosti nga Podgorica. Të tria skuadrat e Kosovës ndeshjet e para do t'i luajnë si mysafirë, më 7 korrik, ndërsa ato të kthimit një javë më vonë. Më fat kanë qenë edhe dy skuadrat e tjera

Aktivitetet të shumta organizohen në kuadër të Javës Olimpikë 2022



PRISHTINË, 14 QERSHOR - Të martën është hapur edhe zyrtarisht Java Olimpikë 2022, në të cilën organizohen aktivitetet të shumta. Java Olimpikë mbahet prej 13 deri më 17 qershor. Në ditën e fundit, të premten, është paraparë të organizohen aktivitetet në 26 komuna, ku të njëjtën ditë shënohet Dita Olimpikë. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka folur për aktivitetet që do të organizohen, derisa ka bërë thirrje që sa më shumë

fëmijë të bashkohen në aktivitetet, në mënyrë që bashkërisht t'i promovojnë vlerat olimpikë dhe njëkohësisht të ndikojnë në masivizimin e sportit në Kosovë. Sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, ka theksuar se këtë herë Java Olimpikë organizohet më herët për shkak të udhëtimit javën e ardhshme të ekipit mesdhetar të Kosovës në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022". Kryetari i grupit punues,

Halil Sylejmani, ka dhënë detaje për shënimin e Ditës Olimpikë që do të mbahet të premten në 26 komuna. Aktiviteti kryesor mbahet në stadiumin "Fadil Vokrri", ku bashkëpjesëmarrëse është edhe komuna e Prishtinës. Për këtë ka folur udhëheqësi i Departamentit të Sportit, Hizdri Bunjaku. Në organizimin e aktiviteteteve ka ndihmuar edhe Federata e Sportit Shkollor. E pranishme në konferencë ishte edhe nënkryetarja e kësaj federate, Lejla Boshnjaku.

Tirana, afër marrëveshjes me Arlind Ajetin

TIRANË, 14 QERSHOR - Padova e Arlind Ajetit qëndron në Serinë C, Palermo kalon në Serinë B, ndërsa Tirana ëndërron yllin e kombëtares. Arlind Ajeti është në bisedime me ekipin e Tiranës dhe pritet të firmosë në vazhdim nëse çdo gjë shkon sipas planit. Aktualisht, te Padova, ku luan në Serinë C, ish-mbrojtësi i

kombëtares shqiptare po diskuton për një transferim të mundshëm në kampionatin shqiptar. Ai është ulur në tavolinë me drejtuesit e Tiranës, të cilët duan një mbrojtës, duke parë problemet në repartin e prapavijës, pas largimit të Erjon Hoxhallarit. Diskutimet kanë qenë të gjata, por nuk është

arritur asnjë pajtim përfundimtar, teksa lojtari është në Serinë C me Padovën. Burime pranë drejtuesve bëjnë me dije se lojtari është shumë pranë firmës me bardheblutë, ndërsa pas Hasanit ardhja e Ajetit do të ishte goditje luksi. Lojtari ka luajtur me Padovën 26 takime këtë sezon.



E ardhmja e Rejës, në dyshime

TIRANË, 14 QERSHOR - E ardhmja e trajnerit të kombëtares shqiptare në futboll, Edy Reja, është vënë në dyshim pas rezultateve të dobëta. Pas përfundimit të eliminatorëve, trajneri vazhdoi dhe u la të

kuptohet se ky kompeticion do të ishte një lloj prove për të arritur te rinovimi ose jo. Kontrata e trajnerit italian mbaron në nëntor dhe deri atëherë Liga e Kombeve përfundon sepse dy ndeshjet e

fundit do të luhen në muajin shtator. E para është në kuotën e tri pikëve, ndërsa Izraeli 5 pikë, kundrejt 1 pike që ka ekipi shqiptar. 76-vjeçari u shpreh pas humbjes që nuk kemi vdekur ende dhe nuk ka ndër

mend të tërhiqet, sido që të shkojnë ndeshjet e mbetura. Në nëntor është në dorën e Federatës Shqiptare të Futbollit nëse do të rinovojë me trajnerin apo jo. Nuk përjashtohet që rinovimi të mos ndodhë.



Duka për diplomimin e 20 trajnerëve të rinj: Uroj t'i mësoni sa më mirë brezat e ardhshëm

TIRANË, 14 QERSHOR - Është përmbyllur me sukses edicioni i tetë i kursit të licencimit për trajnerë të nivelit "UEFA Pro", që është edhe niveli më i lartë për një trajner futboll. Në këtë kurs, që zgjati për rreth 8 muaj dhe që u udhëhoq nga sektori i Edukimit në FSHF, morën pjesë 20 trajnerë, të cilët kanë ndjekur kurrikulën e përgatitur nga UEFA, në bashkëpunim me FSHF-në. Përmes një ceremonie të zhvilluar në ambientet e Shtëpisë së Futbollit janë shpërndarë edhe diplomat për pjesëmarrësit, teksa të pranishëm ishin edhe presidenti i FSHF-së, Armand Duka dhe sekretari i Përgjithshëm, Ilir Shulku. "Ky është një event shumë i rëndësishëm për futbollin që përgatit nivelin më të lartë të edukimit nga shkolla jonë e futbollit. Me kënaqësi kam kërkuar të jem pjesë e finalizimit të këtij kursi sot, për t'ju falënderuar për të gjithë kontributin tuaj, gjatë periudhës së kursit apo gjatë edhe kurseve të tjera dhe, gjithashtu, për ta falënderuar edhe stafin për



punën e bërë dhe për t'ju uruar suksese në vazhdim në punën e trajnerit. Dihet që shtyllat kryesore të futbollit janë mësimdhënia apo trajningu nga trajnerët, që është e para, infrastruktura që është e dyta dhe pak talent nga fëmijët. Por kryesisht punë, punë, punë dhe shumë pak talent. Uroj që t'i mësoni brezat e ardhshëm dhe ju ftoj që mos të shpëputeni nga futbollit për asnjë çast. Të vazhdoni,

pasi futbollit është një nga gjërat e bukura që mund të ndodhë në jetë. Ju të gjithë keni luajtur në nivele të ndryshme dhe e dini se sa përvoja të mira fiton nga futbollit dhe këto përvoja t'ua jepni fëmijëve për të ardhmen", ka thënë Duka. Presidenti Duka dhe sekretari Shulku shpërndanë diplomat UEFA PRO për 20 trajnerët të cilët arritën ta përfundojnë me sukses kursin.

Golden State mposht Bostonin, i afrohet titullit kampion në NBA

SAN FRANCISCO, 14 QERSHOR - Për herë të parë në këto finale "play-off" të NBA-së skuadra e Golden States merr kryesimin. Ekipi i Warriorsit mundi me rezultat 104-94 rivalët e Boston Celticsit, duke udhëhequr 3-2 serinë e takimeve mes dy finalistëve. Një ndeshje në përgjithësi e ekuilibruar, ku të dyja skuadrat luftuan fort për fitore, pasi tashmë çdo gabim është i parikuperueshëm. Skuadra e Warriorsit e shfrytëzoi në maksimum faktorin fushë, duke e merituar fitoren. Vendasit u shkëputën 51-39 në përfundim të pjesës së parë, por Celticsi rikuperoi në periodën e tretë. Gjithsesi, çereku i fundit foli sërish për Golden Staten, që u shkëput dhe e ruajti epërsinë deri në fund. Ai që bëri diferencën në këtë ndeshje ishte Andrew Wiggins, autor i 26 pikëve e 13



reboundeve, mbështetur nga Thompsoni me 21 pikë e Curry me 16. Për Bostonin, Tatum realizoi 27 pikë e Smarti 20, por që s'mjaftuan për të fituar. Ndeshja e gjashtë do të

luhet në fushën e Bostonit (16 qershor), që synon fitoren për ta rikthyer barspeshën, ndërsa Golden State është një fitore larg titullit kampion.

Interi heq dorë nga transferimi i Lukakut

Romelu Lukaku ishte bërë prioriteti i Interit deri para pak ditësh. Sulmuesi belg dëshpëroi me përvojën e tretë në Chelsea dhe pritet të largohet nga Londra në afatin

kalimtar të verës. Mediet e huaja raportojnë se ish-futbollisti i Evertonit dhe i Manchester Unitedit do të rikthehet te nënkampioni i Italisë, por gazetari i "HNL",

Kristof Terreur, raporton se "nerazzurri" e ka ftohur interesimin për përfaqësuesin belg për shkak se klubi italian është duke i konsideruar mundësitë financiare para se

ta bëjë këtë lëvizje. Ndërkohë, thuhet se gjiganti i sulmit është duke u munduar me të gjitha forcat që të rikthehet në Itali, por që tash Interi nuk duket më i interesuar si më

parë për të. Lukaku kishte shkëlqyer në Serinë A me zikaltrit, të cilët i kishte udhëhequr drejt titullit të kampionit në Serinë A, të parin pas 11 vjetësh pritjeje.

SHKURT

Kompany emërohet trajner i Burnleyt

Vincent Kompany është emëruar trajner i ri i Burnleyt. Këtë gjë e ka bërë me dije vetë klubi anglez. Ish-mbrojtësi belg ka drejtuar ekipin e Anderlechtit për tri sezonet e fundit. "Jam i emocionuar nga sfida përpara. Burnley Football Club është një skuadër vërtet historike angleze dhe është nder të emërohem trajner i ekipit të parë. Kam qenë i impresionuar nga vizioni i bordit për klubin që përputhet me vizionin tim dhe mezi pres të luaj rolin tim teksa hyjmë në një sezon të rëndësishëm", ka thënë Kompany. Ish-mbrojtësi i Belgjikës, Kompany, kaloi 11 vjet te City, ku fitoi 10 trofe të mëdhenj, përfshirë katër tituj të Premierë Ligës.

Bayerni kërkon 50 milionë për Lewandowskin

Sulmuesi Robert Lewandowski ka shprehur haptazi dëshirën e tij për t'u larguar nga Bayern Munchen në afatin kalimtar të verës. Por, deri më tani klubi gjerman e ka penguar largimin e tij, pasi që Lewandowski ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2023. Megjithatë, "Catalunya Radio" ka raportuar se Bayerni do ta lejojë largimin e 34-vjeçarit vetëm nëse Barcelona paguan 50 milionë euro. Kujtojmë se më herët është raportuar se Lewandowski ka marrëveshje personale me Barcelonën dhe se po pret vetëm që të arrihet edhe një marrëveshje mes klubeve.

Tenistja Jelena Dokiç: Kisha makthe, po bëhesha gati të hidhesha nga kati i 26

Jelena Dokiç, ish-tenistja 39-vjeçare, ka rrëfyer dramën e saj në rrjetet sociale. Ish-numri 4 në botë ka pasur një jetë të ndërlikuar, fillimisht me babanë, ndërsa më pas me "demonë" të tjerë. Jelena ka zgjedhur rrjetet sociale për ta rrëfyer dramën e saj, ka edhe një datë fikse, 28 prill 2022: "Në këtë datë, që nuk do ta harrojë kurrë në jetën time, ndodhesha në katin e 26 të banesës. Në një moment mendova të hidhesha nga ballkoni për t'i dhënë fund jetës. Gjithçka ishte e errët, kisha makthe dhe dhimbje. Nuk mund ta imagjinoni dot se çfarë ndjeja në ato momente", rrëfeu ish-tenistja.

Belotti largohet nga Torino, kërkohet nga Fiorentina dhe Monza

Andrea Belotti nuk do të vijojë të jetë më pjesë e Torinos duke filluar nga sezoni i ardhshëm. Sipas asaj që raporton e përditshmja sportive italiane "TuttoSport", kapiteni granata ua ka komunikuar shokëve të skuadrës vendimin për ta lënë ekipin e Torinos. Sulmuesit 28-vjeçar është në skadencë kontrate më 30 qershor dhe pritet të shpallë "divorcin" me torinezët pas shtatë sezonesh. Kanë filluar sondazhet e para për të. Kampionin e Evropës me Italinë e kërkojnë Fiorentina dhe e sapo ngjitura në Serinë A, Monza e Silvio Berlusconi dhe e Adriano Galianit. Në sezonin që përfundoi me fanellën e Torinos në Serinë A, "gjeli" Beloti u aktivizua në 22 ndeshje dhe shënoi tetë gola dhe dhuroi gjithashtu një asistim.



CONTRACT AWARD NOTICE

SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 14/06/2022

Procurement No	Mentoring	002	2022	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:
Individual consultancy- Mentoring and Coaching for 560 new beneficiaries
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance
(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

	<input checked="" type="checkbox"/> Services
	Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract
Individual consultancy- Mentoring and Coaching for 560 new beneficiaries
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots

NO

II.1.7) Contract value: 170,240.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award	14/06/2022
IV.2) Intended date of contract signing	23/06/2022
IV.3) Number of received tenders	4
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded	
Official name: "SMART INOVATION CENTRE"-SIC Str. Agim Ramadani A3 Prishtinë	
Postal address: 10000 Prishtinë	
Town: Prishtinë	Postal code: 10000
Country: Kosovo	
URL (if applicable):	
Contact point(s): Xhylljeta Luzha	Email: info@sic-kos.com
Telephone: +383 44/45 817477	Fax: +38338748701

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 170,240.00 Euro

Responsive tender with lowest price: 170,240.00 Euro

Responsive tender with highest price: 196,000.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Avokate Erlinda Elezi Tosku" SH.P.K. Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811357682 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Avokate Erlinda Elezi Tosku" Gnjilane D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811357682 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Avokate Erlinda Elezi Tosku" L.L.C. Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811357682 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mihran Branovi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

► Fiedon Bytyqi shpall të pavlefshme 3 dëftesat , certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Bardh Spaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezh.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Bashkëpunëtor Profesional, Tridhjetenëntë (39) vende pune

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, dy (2) pozita
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pesëmbëdhjetë (15)
Prokuroria Themelore Prishtinë, pesë (5) pozita
Prokuroria Themelore Prizren, pesë (5) pozita
Prokuroria Themelore Ferizaj, katër (4) pozita
Prokuroria Themelore Pejë, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Mitrovicë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Gjakovë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Gjilan, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 010
Emri pozitës: Bashkëpunëtor Profesional
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave: Tridhjetenëntë (39)
Koeficienti: 9
Akti i emërimit: Pa afat
Vendi: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan

Qëllimi i vendit të punës:

Bashkëpunëtori profesional, ofron mbështetje profesionale për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësitë të prokurorit të shtetit, përmes hulumtimit, këshillimit dhe hartimit të akteve ligjore në fushëveprimtarinë e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin e lëndës detyrën dhe aktet e specializuara për miratim,
Mbështetë prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre;
Merr pjesë në cilësinë e ekspertit në seanca dëgjimore dhe në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;

Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;

Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të institucionit;
Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha Juridike;
Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj).
Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, hartim të propozim akuzave, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.

Provimi i jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

3 vite përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 15.06.2022 deri me datë 29.06.2022 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi ose kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
 - Dy rekomandime (nëse kenë);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetim.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen buzuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2021 od 15 Februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljuje:

KONKURS

I. Stručni Saradnik, tridesetidevet (39) radno mesto

Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca, dve (2) pozicije
Specialno Tužilaštvo Republike Kosovo, petnaest (15) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Pristina, pet (5) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Prizren, pet (5) pozicije;
Osnovno Tužilaštvo Uroševac, četiri (4) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Peć, tri (3) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, dve (2) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Đakovica, dve (2) pozicije
Osnovno Tužilaštvo Gnjilane, jedna (1) pozicija

Referenca : Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ - 010
Naziv Pozicije: Stručni Saradnik
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
Broj Pozicija: Tridesetidevet (39) pozicije
Koeficijent: 9
Akt imenovanja: Na neodređeno
Mesto: Pristina, Prizren, Peć, Mitrovica, Đakovica, Uroševac, Gnjilane

Cilj radnog mesta:

Stručni saradnik, pruža stručnu podršku u obavljanju poslova i odgovornosti državnog tužioca, kroz istraživanje, konsultacije i izradu pravnih akata iz oblasti delatnosti državnog tužioca.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Razvije i dostiže saglasnost za radne planove i rokove, u koordinaciji sa nadzornikom, za sprovođenje dotičnih postupaka , usluga i proizvoda u specifično stručno polje;
Vrši predviđene dužnosti planom rada usvojenog u saglasnosti sa zakonom, pravilnicima, politikama i relevantnim procedurama, unutar vremenskih rokova;
Vrši istraživanje, analize, procenu opcija i preporučuje pretres dokumentacije sa nadzornikom predmeta, dužnost i specijalizovana akta za usvajanje;
Učestvuje u svojstvu stručnjaka na saslušanjima i sudskim ročištima kada mu se ovo zatraži;
Pobrinjava se za očuvanje službene tajne u vezi predmeta i informacija do kojih dolazi tokom rada;
Podržavaju tužioce u vršenju njihovih funkcija;

Koordinira rad sa ostalim jedinicama institucije i komunicira po potrebi i sa spoljnim autoritetima, uvek brineći se za dostojanstveno predstavljanje institucije;
Vrši svaku drugu dužnost u specifičnu stručnu oblast u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koja se povremeno može zatražiti na razuman način.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Sveobuhvatna odlična stručna poznavanja iz oblasti prava;
Dobra poznavanja rada na računaru sa primenom programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, i dr).
Sposobnosti za razmatranje predmeta, izradu predlog optužnica, optužnica i ostalih potrebnih spisa;
Spreman da radi za ljudima raznih nacija i religija;
Sposobnosti za preduzimanje konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi istog;
Sposobnosti održanja kvaliteta rada u uslovima rada pod tenzijom;

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet .

Pravosuđni ispit.

Radno Iskustvo:

3 godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 15.06.2022 do 29.06.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
 - "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda ili radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK, ju rikujton aplikimin e ngarkesës së kundërt të TVSH-së në furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit

Administrata Tatimore e Kosovës, ju rikujton se në muajin dhjetor/2019 ka nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 03/2019 - Detyrimi për të paguar TVSH-në për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit – Aplikimi i ngarkesës së kundërt.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të TVSH-së për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit, respektivisht aplikimin e ngarkesës së kundërt (Reverse Charge) për TVSH, brenda vendit.

Shërbimet ndërtimore të ofruara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, trajtohen sipas Vendimit Shpjegues Publik Nr. 03/2019.

Vendimin Shpjegues Publik Nr.03/2019 - Detyrimi për të paguar TVSH-në për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit – Aplikimi i ngarkesës së kundërt, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së www.atk-ks.org në linkun Publikime.

ATK, në implementim të Projektit “Përbushja në Sektorin e Ndërtimitarisë”!

Administrata Tatimore e Kosovës



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

